Numri 2 Nëntor 2017

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

UniVlora Newsletter

Përmbajtja:

Fjala përshëndetëse e dekanes të Fakultetit të Shëndetit Publik Prof. Asoc. Aurela Saliaj f.2

Aktivitet i Fakultetit të Shendetit Publik, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Diabetit f.4

Takim i përfaqësuesve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në Parlamentin Bullgar f. 5

Takim i zhvilluar në Sofje, Bulgari ne Universitetin të Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë f.6

Takim me Ambasadoren Greke f.7

Akreditimi f.8

Vendim i Senatit Akademik nr 94 f.8

Marrëveshje bashkepunimi me Universitetin të Malit të Zi (UoM) f.9

Ceremonia e diplomimit f.10

Takimi i Shoqatës Sportive Studentore f.12

Kupa Pavarësia f.13

CEREMONIA E DIPLOMIMIT TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

Ditën e Martë datë 31.10.2017 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë zhvilloi në ambientet e sallës "Rilindja" Ceremoninë e Diplomimit për vitin akademik 2016-2017, një nga eventet më të rëndësishme dhe të shumëpritur për universitetin dhe studentët ... f.10

Re@WBC

Më datë 2 Nëntor në ambientet e rektoratit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, u mbajtën dy takime informuese mbi vijueshmërinë dhe mbarëvajtjen e fazës së dytë të projektit Erasmus + KA2 "Enhancement of HE research potential contributing to further groëth of the ËB region" (Re@ËBC)... f.3

Takim në Universitetin e Sarajevës për projektin Re@WBC f.2

FJALA PËRSHËNDETËSE E DEKANES TË FAKULTETIT TË SHËNDETIT PUBLIK PROF. ASOC. AURELA SALIAJ

Misioni madhor i Fakultetit të Shëndetit Publik është të rritë standartet e shëndetit komunitar nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit. Qëllimi ynë konstant është të vazhdojmë të ofrojmë programe akademike infermierore me njohje dhe reputacion ndërkombëtar, në mënyrë që diplomat që ne japim të njihen nga tregu ndërkombëtar i punës.

Fakulteti ynë është i përkushtuar për formimin profesional të infermierëve të përgjithshëm dhe specialistë (mami, pediatër, patolog, kirurg, shëndet publik),që ata të jenë plotësisht kompetentë për të përmbushur nevojat që parashtron profesioni i tyre, në një mjedis dinamik të kujdesit shëndetësor komunitar.Ky fakultet ofron mundësi jo vetëm për formimin infermieror bazë, por edhe për karrierë infermierore të mëtejshme nëpërmjet diplomave të nivelit të dytë për mastera profesionale dhe shkencorë, ku përfshihen edhe programe në fushën e mësimdhënies dhe menaxhimit infermieror.

Një staf akademik i kualifikuar dhe në proces kualifikimi të vazhdueshëm ofron kurrikula dhe performancë mësimore bashkëkohore. Pedagogët tanë janë në çdo kohë të gatshëm për t'iu ofruar studentëve të FSHP eksperiencën dhe bashkëpunimin e tyre, në çdo fushë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Ju ftojmë të bëheni pjesë e sistemit tonë akademik, të punojmë së bashku për krijimin e gjeneratës së re shëndetësore dhe infermierore, që do të jetë lider në suksesin e strategjisë së Ministrisë së Shëndetësisë për shëndetin komunitar të së ardhmes!

Takim në Universitetin e Sarajevës për projektin Re@WBC

Më datat 6 dhe 7 nëntor 2017 pranë Universitetit të Sarajevës, Bosnjë-Hercegovinë, pedagogë të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësuar nga Zv/Rektori për Zhvillim Institucional dhe Komunikim, PhD Enkelejd Mëhilli, si edhe Prof. As. Dr. Armela Panajoti, pikë kontakti për projektin Erasmus + KA2 "Enhancement of HE research potential contributing to further growth of the WB region" (Re@WBC) patën një takim zyrtar me partnerët e këtij projekti.
Në këtë takim dyditor pjesëmarrësit e UV-së raportuan tek partnerët dhe diskutuan me ta për mbarëvajtjen dhe arritjet e projektit në fjalë gjatë dy viteve të para të zbatimit të tij. Gjithashtu, u nënvizua mbështetja institucionale për zbatimin e strategjisë për kërkuesit e rinj pranë UV-së, si edhe u ndal në politikat e universitetit për promovimin e kësaj strategjie në kuadër të reformave të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, punës dhe detyrave të këtij institucioni në vijim.
Bisedat, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave të ndërsjella midis institucioneve partnerë ishin një nga përparësitë e përfaqësuesve të UV-së, në dobi të përvijimit të punës akademike, pedagogjike dhe administrative lidhur me synimet e këtij projekti. Përmbushja e detyrave dhe angazhimeve institucionale në këtë kuadër për vitin e tretë dhe të fundit ishin epiqendër në këto takime të vlerësuara dhe mjaft të frytshme.

Prezantim i Re@WBC

Me datë 2 nëntor, pranë ambienteve të Rektoratit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, u mbajtën dy takime informuese mbi vijueshmërinë dhe mbarëvajtjen e fazës së dytë të projektit Erasmus + KA2 "Enhancement of HE research potential contributing to further groëth of the ËB region" (Re@ËBC).

Në takimin e parë me pjesëmarrës të personelit administrativ, Rektori i UV-së, Prof. Dr. Roland Zisi, Prof., pedagogu Prof. Asoc. Dr. Bledar Toska si edhe anëtarë të tjerë të grupit të punës u ndalën në zbatimin e arritjeve të projektit lidhur me rolin e këtij personeli në përmbushjen e qëllimeve të tij.

Në takimin e dytë me një pjesëmarrje të gjerë të kërkuesve të rinj pranë UV-së, u paraqit një sintezë përmbledhëse e synimeve dhe ambicieve të këtij projekti për ngritjen dhe përmirësimin e aktivitetit, statusit dhe promovimit akademik të shkencëtareve të gjeneratës së re në UV.

Diskutimet dhe pyetjet në këto takime pasuan informimin dhe prezantimin e ecurisë së suksesshme të zbatimit të projektit në bashkëpunim me partnerët evropianë dhe ata ballkanas.

Takim i Fakultetit të Shendetit Publik, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Diabetit

Në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Diabetit, 14 Nëntor 2017 ", Qendra Studimore për Shëndetin Publik, në bashkëpunim me Departamentin e Infermierisë, Fakulteti I shëndetit Publik, UV, organizoi aktivitetin promocional me temë:
"Komuniteti, moshat e treta dhe diabeti – e drejta jonë për një të ardhme të shëndetshme", me koordinatore Glodiana Sinanaj dhe grup pune : Fatjona Kamberi, Brunilda Subashi, Denada Selfo dhe Rozeta Luçi.

Diabeti është një sëmundje kronike, për shkak të të cilës, trupi nuk mund të prodhojë sa duhet, si dhe të përdorë me efiçencë insulinën, hormonin që kontrollon dhe mban në nivele normale glukozën në gjak. Sëmundja e diabetit ka kosto të lartë sociale, shëndetësore dhe ekonomike. Nëse nuk trajtohet, diabeti mund të shkaktojë ndërlikime të tilla si verbimi apo sëmundjet Kardio-Vaskulare.

Qëllimi i aktivitetit ishte sensibilizimi dhe informimi i moshave të treta, në lidhje me diabetin, depistimin e hershëm, në funksion tëërmirësimit të cilësisë së jetës sëme diabet dhe atyre në rrezik.
Vendi i aktivitetit: Qendra Ditore Multidisiplinare për të, Vlorë.

Të moshuarve ju ofrua informacion në lidhje me sëmundjen e diabetit si dhe matje falas të glicemisë dhe presionit arterial. Këto matje u realizuan nga studentët e Fakultetit të Shëndetit Publik.

Aktiviteti evidentoi se pothuajse të gjithë të moshuarit, pjesëmarrës kishin nivele të larta të glukozës në gjak, ndërkohë që referonin se nuk vuanin apo merrnin mjekim për diabet.

Domosdoshmëria e ngritjes së cilësisë për screening të hershëm por edhe rëndësia për menaxhimin e mirë të diabetit qëndron si parakusht për shmangien e komplikacioneve ë lidhura me diabetin në moshat e treta.

Takim i përfaqësuesve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në Parlamentin Bullgar

Një takim shumë i rëndësishëm dhe I frytshëm u zhvillua midis Prof. Dr. Roland Zisi, Rektor dhe përfaqësues të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, me Z. Krasimir Bogdanov si dhe parlamentarë nga parti të ndryshme të Bullgarisë.

Z. Bogdanov dhe parlamentarët që morrën pjesë në këtë takim, janë grupi i punës në parlamentin Bullgar për miqësinë Bullgari-Shqipëri.

Fillimisht z. Bogdanov:

Falenderoi për viziten dhe ishte shumë entuziast për takimin që po zhvillohej.

Informoi grupin e UV-së për punët që ky grup zhvillon në parlamentin Bullgar.

Falenderoi thellë për njohjen e minoritetit Bullgar në Shqipëri dhe votimin e ligjit nga parlamenti i Shqipërisë.

Theksoi miqësinë dhe marrëdhënien e mirë të dy shteteve të cilat janë në momentin e tyre kulminant.

Nënvizoi dashurinë e tij për Shqipërinë dhe shqiptarët, duke theksuar ndihmën që ai personalisht por edhe parlamenti Bullgar kanë dhënë për Shqiptarët në Bullgari (sidomos studentëve).

Nga ana e përfaqësuesve të UV-së Rektori Prof. Dr. Roland Zisi morri fjalën i pari duke falenderuar për mikëpritjen e ngrohtë dhe për fjalët e mira të z. Bogdanov.

Prof. Dr. Roland Zisi:

E informoi për vizitën e grupit të UV-së në Bullgari (Një takim shumë i rëndësishëm midis Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Universitetit të Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë të Sofjes. Ky takimi ishte mjaft i frytshëm në të cilin u diskutuan çështje mjaft të rëndësishme).

Informoj për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis 2(dy) Universiteteve (Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Universitetit të Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë të Sofjes).

Theksoi lidhjet dhe marrëdhëniet e mira që dy shtetet kanë por dhe që kanë pasur në të kaluarën duke përmendur edhe kurorëzimin e mbretit të Bullgarisë në Bylis (Mbreti i Bullgarisë, shqipfolës dhe mik i shqiptarëve i asaj kohe).

Informoi për takimin që u bë në UV për ditën e pavarësisë së Bullgarisë (Në kuader të ditës se çlirimit te Bullgarise që ishte 3 Marsi, Ambasadori i Bullgarisë, Dimitar Arnaudov në bashkëpunim me Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë organizuan një ceremoni ku u diskutua mbi zanafillen e marrëdhënieve mes shteteve dhe ndihmën e Bullgarisë në rrugëtimin e vendit tonë drejt Bashkimit Europian).

Informoi për diskutimet që UV ka me universitete të tjera Bullgare për marrëveshje bashkëpunimi.

Theksoi qëllimin kryesor që UV ka (ndërkombtarizimin) duke theksuar se Bullgaria dhe Universitetet Bullgare janë partnerë strategjikë për arritjen e këtij qëllimi.

Prof. Dr. Zisi para se të mbaronte fjalimin ju uroi suksese në sfidën e vështirë që Bullgaria ka 6 mujorin e parë të 2018 për drejtimin e presidencës së Bashkimit Europian si dhe i ftoi në Vlorë për një vizitë pune

Nga ana e tij z. Bogdanov falenderoi Rektorin Prof. Dr. Roland Zisi për ftesën të cilën ai e pranoi me kënaqësi.

Së fundmi, ai i dha fjalën me rradhë gjithë anëtarëve të parlamentit që morrën pjesë në takim duke theksuar marrëdhëniet e mira midis dy shteteve si dhe duke na ofruar ndihmën e tyre për kontakte dhe lidhjen e marrëveshjeve me IAL Bullgare.

Nga ana e përfaqësuesve të Universitetit, e morrën fjalën PhD Enkelejd A. Mëhilli, Prof.Asoc.Hajdar Kiçaj, Dr. Eva Çipi, të cilët falendruan për mikpritjen e ngrohtë, duke analizuar disa nga rezultatet e vizitës në Sofje dhe duke u shpjeguar hapat e mëtejshme të këtyre marrëdhënieve.

Takimi i zhvilluar në Sofje, Bullgari ne Universitetin të Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë

Një takim mjaft i rëndësishëm u zhvillua në datën 19-10-2017 në Sofje të Bullgarisë ndërmjet përfaqësuesve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe atyre të Universitetit të Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë të Sofjes. Përfaqësues të UV ishin Prof. Dr. Roland Zisi – Rektor, PhDEnkelejd A. Mëhilli – Zv. Rektor, Prof.Asoc.Hajdar Kiçaj – Dekan i Fakultetit të ShkencaveTeknike, Dr. Eva Çipi – pedagoge Departamenti i Shkencave-Kompjuterike. Universiteti i Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë u përfaqësua nga Prof. Dr. Mitko Georgiev– Rektor UCTM.

Takimi ishte mjaft i frytshëm dhe konstruktiv. Në të u diskutuan çështje mjaft të rëndësishme për të ardhmen e institucionit tonë.

Nga ana e përfaqësuesve të Universitetit të Vlorës, u kërkua nënshkrimi i një marrëveshjeje Erasmus për mobilitete studentësh dhe personeli të UV-së.

Përfaqësuesit tanë kërkuan organizimin Konferencave të përbashkëta në Vlorë dhe në Sofje si dhe ndërmarrjen e hulmutimeve të përbashkëta.

Prof. Dr. Roland Zisi, Rektor I Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë i kërkoi Prof. Dr. Mitko Georgiev- Rektor i Universitetit të Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjike të Sofjes organizimin e përbashkët të Kurseve të Shkurtra.

Për sa më sipër, kërkesat tona u pranuan nga ana e Universitetit të Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë të Sofjes.

Gjithashtu, u ra dakord edhe për nënshkrimin e një marrëveshjeje Erasmus si dhe për organizimin e Konferencave të përbashkëta.

Rektori i Universitetit të Teknologjisë Kimike dhe Metalurgjisë të Sofjes, ftoi një përfaqësi të studentëve të UV të frekuentojnë aktivitetin: "Dita e Shkencës dhe Sporteve (Day of Science and Sports)"në Maj 2018, duke marrë përsipër edhe shpenzimet e akomodimit.

Gjithashtu Rektori i UV- së dhe Prof. Dr. Mitko Georgiev UTKM të Sofjes, diskutuan dhe ranë dakort për mundësinë e publikimit të artikujve shkencorë, prej pedagogëve dhe studentëve të UV-së në revistën"Journal of Chemical Tecnology and Metallurgy" [(http://dl.uctm.edu/journal/node/1) me factor tre (3)]

Midis përfaqsuesve të dy institucioneve u diskutua mundësia për bashkëpunim në përmirësimin e cilësisë dhe të kualifikimit të personelit të UV –së, duke specifikuar mundësine e zhvillmit të doktoratës në Sofje.

Takim me Ambasadoren Greke Znj. Eleni Surani

Në datën 26.10.2017 Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë,Prof. Dr. Roland Zisi dhe Zv. Rektori Ph.D Enkelejd Mëhilli zhvilluan një takim pune me Ambasadoren Greke, Znj. Eleni Surani, si dhe Zv. Ambasadorin z. Grigoris Delavekouras.

Fillimisht Rektori i UV prezantoi universitetin si dhe e informoi znj. Ambasadore per marrëdhëniet e mira te Universitetit me Institucione te Arsimit te lartë Helene, si atë të Janines, Kretës dhe Korfuzit. Nga ana e saj, znj. Surani theksoi se vizioni dhe qëllimi i saj janë të dyfishtë. Të përmirsojë marëdhëniet institucionale midis universiteteve shqiptare dhe atyre greke si dhe marëdhëniet midis studenteve me qellim vendosjen e kontakteve ndërstudentore.

Përmirsimi i marrëdhënieve midis IAL-ve të dy shteteve është nje nga qëllimet institucionale të znj. Surani. Në kuadër të marrëdhënieve ndërstudentore, znj. Ambasadore propozoi që nje grup studentësh të UV, me mbulimin financiar të ambasadës, të vizitojnë Greqinë, me qëllim vendosjen e kontakteve njerëzore, që do të ndihmojë në avancimin e marrëdhënieve shumë të mira që kanë dy popujt tanë. Znj. Surani propozoi që në këtë vizitë të përfshihen studentë me vështirësi ekonomike,të cilët nuk kanë mundësi të kryejnë udhëtime jashtë Shqipërisë.

Rektori i UV e falenderoi znj. ambasadore dhe e pranoi me kënaqësi propozimin. Në vazhdim të takimit nga ana e Rektorit te UV u kërkua:

-Të jepen 2 (dy) bursa studimi për studentët e UV-së , 1 (një) student bachelor dhe 1(një) student master. Per këtë kërkesë,znj ambasadore ra dakord dhe u angazhua që kjo kërkesë të plotësohet sa më shpejt.

2-Ndihma e ambasadës për realizimin e testit zyrtar të gjuhës greke në UV (pajisja me çertifikatë).

Në këtë pikë, znj ambasadore mori angazhim që do t'a vlerësonte dhe do të informonte rektorin e UV.

3-Nga ana e ambasadës të financohet pagesa e një pedagogu, me qellim që gjuha greke te jete lëndë me zgjedhje.

4-Zhvillimin e leksioneve të hapura për studentët me qëllim njohjen e historisë dhe kulturës së Greqisë dhe Shqipërisë për të forcuar miqësinë e dy popujve fqinjë.

Per dy pikat e fundit znj. Ambasadore ishte pozitive dhe e hapur per t'I diskutuar gjatë muajve të ardhshëm me qëllim realizimin e tyre vitin tjetër akademik.

-Se fundi Ambasadorja Greke gjithashtu propozoi pjesëmarrjen e kompanive greke gjatë Open Day që zhvillon UV. Kjo mund të ndihmojë dhe në punësimin e studentëve në këto biznese.,

Në përfundim të këtij takimi të parë dhe mjaft të frutshëm, prej të dyja palëve u ra dakord, që në frymën e vendosur të zhvillohen edhe takime të tjera, me qëllim vendosjen e një bashkëpunimi fitimprurës.

Akreditimi

Akreditimi institucional i institucioneve të arsimit të lartë në vend ishte një proçes mjaft i rëndësishëm. Ky proçes vendosi përballë përgjegjësisë të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Kërkesat për akreditimin institucional janë të gjithanshme dhe mbulojnë çdo sferë të jetës akademike, të jetës studentore, të proçesit të mësimdhënies si dhe të organizimit të universiteteve . Pjesëmarrja në një proçes të tillë garanton që edhe në vitet në vijim do të angazhohemi për të maksimizuar benefitet prej pikave tona më të forta dhe për të përmirësuar dhe tejkaluar pikat tona të dobëta, duke garantuar kështu një përmirësim të cilësisë institucionale të universitetit tonë.

Universiteti "Ismail Qemali " Vlorë është akredituar në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit me nr.71, datë 21.09.2017 . Akreditimi është i vlefshëm deri më 30.09.2020

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZYRA E PROTOKOLL-ARKIVES
Nr 10303 Prot
Datë 02.11.2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Certifikatë Akreditimi

Institucioni i Arsimit të Lartë, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, akreditohet në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 71, datë 21 / 09 / 2017.

Akredimi është i vlefshëm deri më 30 / 09 / 2020.

Kjo çertifikatë është e vlefshme vetëm e shoqëruar me Vendimin e B.A.

Arjan Gjonça
Kryetari i BA

Dhurata Bozo
Drejtori ASCAL

Nr. i serisë AI 016

Nr. regjistër 16 datë 29/09/2017

VENDIM I SENATIT AKADEMIK 94, datë 13.10.2017

Në bazë të Vendimit të Senatit Akademik nr 94, datë 13.10.2017,është krijuar një adresë të posaçme elektronike për adresimin e ankimimeve dhe shqetësimeve të studentëve dhe stafit akademik në lidhje me shkeljen e standardeve akademike, procesit të mesimdhënies, etikës akademike, konfliktit të interesit apo çdo shkelje tjetër që cënon integritetin apo të drejtat e studentëve dhe personelit akademik.

ankesa@univlora.edu.al

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

Në datën 21.10.2017, në ambientet e Universitetit të Malit të Zi (UoM) u organizua takimi për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV) dhe Universitetit të Malit të Zi (UoM).

Marrëveshja e bashkëpunimit, e cila u negociua dhe u përgatit prej Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Prof. Dr. Roland Zisi dhe Rektorit të Universitetit të Malit të Zi, Prof. Dr. Danilo Nikolic, pasqyron vullnetin e përbashkët për vendosjen dhe zgjerimin e marrëdhënieve të dy institucioneve në të gjitha fushat sidomos në atë të zhvillimit të punës kërkimore shkencore.

Marrëveshja synon bashkëpuniminin në fusha me interes të përbashkët kryesisht në lëmin akademik dhe shkencor, në shkëmbime pedagogësh, kërkuesish shkencorë, personeli administrativ dhe studentësh. Në të dy universitetet do të caktohet një officer/ kordinator për të hartuar dhe ndjekur aktivitetet specifike të këtij bashkëpunimi 5 vjeçar. Bashkëpunimi midis dy universiteteve vjen pas implementimit me suksses të projektit MArED-Tempus, 5 vjet më parë.

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes morrën pjesë gjithashtu Presidenti i Bordit Drejtues të Universitetit të Malit të Zi, Prof. Dr. Duško Bjelica, Zëvendës Rektori, PhD. Enkelejd Mëhilli, Përgjegjësi i Grupit Mësimor të Shkencave Detare, pranë Fakultetit të Shkencave Teknike, Prof. Asoc. Kristofor Lapa dhe Përgjegjësi i Departamentit të Edukimit, pranë Fakultetit Shkencave Humane, Dr. Aranit Gjipali.

Marrëveshja u firmos nga Rektori i UoM Prof. Danilo Nikolic dhe nga Rektori i UV Prof.Dr. Roland Zisi.

Afati i nënshkrimit të marrëveshjes është 5 (pesë) vjet duke lënë hapur mundësinë e një bashkëpunimi të mëtejshëm.

CEREMONIA E DIPLOMIMIT TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

Ditën e Martë datë 31.10.2017 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë zhvilloi në ambientet e sallës "Rilindja" Ceremoninë e Diplomimit për vitin akademik 2016-2017 , një nga eventet më të rëndësishme dhe të shumëpritur për universitetin dhe studentët . Ceremonia u hap me fjalën përshëndetëse të Rektorit Prof. Dr. Roland Zisi i cili uroi studentët për realizimin me sukses të studimeve të tyre, duke i përgëzuar për punën e kryer dhe duke ju uruar mbarëvajtje të mëtejshme në arritjen e objektivave të tyre në të ardhmen.

Këtë vit akademik u diplomuan në total 539 studentë në Fakultetin e Ekonomisë, 391 studentë në Fakultetin e Shkencave Teknike, 500 studentë në Fakultetin e Shkencave Humane, 320 studentë në Fakultetin e Shëndetit Publik.

Në këtë event morrën pjesë Dekanët e fakulteteve, stafi akademik si dhe familjarët e gjithë studentëve.

Në përmbyllje të ceremonisë, momenti i shumëpritur i hedhjes së kapeleve emocionoi jo vetëm studentët dhe familjarët e tyre, por edhe të gjithë të pranishmit.

Institucioni ynë, duke shpresuar se dija e marrë në këto vite të bukur që kaluam bashkë do t'ju shërbejë si një fillim i mirë në rrugën e gjatë të jetës profesionale, ju uron tashmë ish studentëve, të kenë një të ardhme me realizime dhe suksese. Urime!

Institucioni ynë, duke shpresuar se dija e marrë në këto vite të bukur që kaluam bashkë do t'ju shërbejë si një fillim i mirë në rrugën e gjatë të jetës profesionale, ju uron tashmë ish studentëve, të kenë një të ardhme me realizime dhe suksese. Urime!



Takimi i Shoqatës Sportive Studentore

Ditën e Premte datë 03.11.2017 në ambjentet e Rektoratit të Universitetit të Tiranës, u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Shoqatave Sportive Studentore të Universiteteve Shqiptare. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë u përfaqësua nga Z. Gjergji Iliadhi kordinator i aktiviteteve sportive pranë Sektorit të Komunikimit dhe Publikimeve. Ky takim kishte si qëllim vendosjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit midis universiteteve, shkëmbimin e eksperiencave si dhe angazhimin sa më të gjerë të studentëve në jetën studentore sportive. Si akt shumë i rëndësishëm i ketij takimi ishte themelimi i Federatës Shqiptare Sportive Universitare. Me votim të fshehtë u zgjodhë Presidenti si dhe 4(katër) anëtarët e Komitetit drejtues të Federatës:

Besnik Veliu : President (kryetar)
Universiteti i Tiranës

Gjergji Iliadhi : Anëtar
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Ulpian Hoti : Anëtar
Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës

Mimoza Tare : Anëtar
Universiteti Universiteti i Tiranës

Taulant Spahiu: Anëtar
Universiteti i Mjeksisë Tiranë

KUPA PAVARËSIA

Ditën e premte, datë 24.11.2017, prej Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë, nën kujdesin e veçantë të Zv. Rektorit, phd Enkelejd Mëhilli, dhe me mbështetjen e Bashkisë Vlorë, dhe në kuadër të festive të Nëntorit, u zhvilluan ndeshjet për kupën "Pavarësia" në volejboll dhe minifutboll. Aktiviteti parashikonte: 1- ndeshje minifutbolli meshkuj,midis stafit të UV dhe ekipit të gazetarëve, 2- volejboll femra midis studenteve të UV dhe ekipit të gazetareve, 3- minifutboll meshkuj midis ekipeve të studentëve sipas fakulteteve.

Aktiviteti u mbyll me fitoren e ekipeve përfaqësues të UV në minifutboll dhe volejboll, si dhe me fitoren e "Fakultetit të Ekonomisë" në përballjen midis fakulteteve.



Universiteti Ismail Qemali Vlorë

U.V. Ismail Qemali

Universiteti Ismail Qemali Vlore

univlora2

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE TONA

Realizuar nga:
Zyra e Publikimeve
Sektori i Komunikimit dhe Publikimeve
Universiteti "Ismail Qemali" Vlore